



SBASHK-u merr pjesë në Forumin e Këshillit Ekonomik Social Evropian për Ballkanin Perëndimor



Në Beçiq të Malit të Zi, gjatë muajit maj kishte mbajtur punimet Forumi i 10-të i Shoqërisë Civile të Ballkanit Perëndimor, i organizuar nga Këshilli Ekonomik Social Evropian (KESE), në të cilin kishin marrë pjesë edhe dy përfaqësues... (faqe 10)

SBASHK po vazhdon me zgjedhjet sindikale, gjatë majit zgjedhjet përfunduan në disa komuna



Gjatë muajit maj, SBASHK ka përfunduar zgjedhjet sindikale në disa komuna të Kosovës, derisa ato po vazhdojnë në të gjitha komunat tjera me ... (faqe 8)

2025-a, Vit Zgjedhor në SBASHK



Viti 2025 është shpallur zyrtarisht nga Këshilli Drejtues i SBASHK-ut si Viti Zgjedhor Sindikal, një vendim

i marrë në mënyrë unanime në mbledhjen e mbajtur më 1 mars 2025... (faqe 3)

Intervistë me kryetarin e SKAP-it në Prishtinë, Qamil Hajdini



Kryetari Hajdini: Të reduktohet ngarkesa e edukatoreve nëpër kopshte e puna jashtë orarit, të ruhen vendet e punës së mësimdhënësve... (faqe 3)

SBASHK-u, gjatë muajit maj, ka organizuar 17 grupe trajnimi në kuadër të zhvillimit profesional të stafit arsimor



Në vazhden e përkrahjes së anëtarësisë së vet sa i përket ngritjes profesionale dhe përmirësimit të kushteve të punës së tyre, SBASHK-u gjatë muajit maj ... (faqe 4)



Sindikata e Bashkuar e Arsimit, Shkencës dhe Kultures
The Union of Education, Science and Culture

Editorial

2025-a, Vit Zgjedhor në SBASHK



Viti 2025 është shpallur zyrtarisht nga Këshilli Drejtues i SBASHK-ut si Viti Zgjedhor Sindikal, një vendim i marrë në mënyrë unanime në mbledhjen e mbajtur më 1 mars 2025. Ky vendim ka shënuar fillimin e një procesi të gjerë dhe gjithëpërfshirës zgjedhor brenda strukturave sindikale të SBASHK-ut, në të gjitha nivelet.

Procesi zgjedhor po zhvillohet me standarde të larta demokratike, në mënyrë të pavarur dhe transparente, duke garantuar votim të fshehtë për të gjitha pozitat sindikale — nga niveli i shoqatave sindikale nëpër institucionet arsimore, kulturore dhe shkencore, te Sindikatat Komunale të Arsimit Parauniversitar (SKAP), e deri te zgjedhja e delegatëve për Kongresin e SBASHK-ut.

Kjo dinamikë zgjedhore është ndjerë në çdo shkollë të Kosovës, duke mobilizuar me përkushtim anëtarësinë dhe

duke nxitur pjesëmarrjen aktive të punëtorëve të arsimit në procesin vendimmarrës sindikal. Deri tani, në shumë shoqata sindikale dhe në shumicën e komunave, zgjedhjet kanë përfunduar me sukses dhe në një frymë të qetë demokratike. Në Prishtinë është zgjedhur kryetari i ri i sindikatës komunale të arsimit parauniversitar, z. Qamil Hajdini; në Kamenicë është rizgjedhur kryetari aktual, z. Lulzim Thaqi; në Shtërpçë është zgjedhur kryetar z. Avni Shabani; ndërsa në Klinë është rizgjedhur kryetar, Arif Elezaj. Zgjedhjet po zhvillohen në përputhje të plotë me statutin e SBASHK-ut dhe janë duke u përcjellë me kujdes nga Komisionet Zgjedhore të ngritura në të gjitha nivelet. Ky proces jo vetëm që dëshmon funksionimin demokratik të brendshëm të SBASHK-ut, por edhe reflekton pjekurinë dhe përkushtimin e anëtarësisë në fuqizimin e mëtejshëm të zërit sindikal në sektorin e arsimit. Zgjedhjet në SBASHK këtë vit po reflektojnë angazhimin dhe përgjegjësinë që çdo anëtar ka marrë për të kontribuar në fuqizimin edhe më të madh të SBASHK-ut - një sindikatë më përfaqësuese dhe më aktive në mbrojtjen e të drejtave të punëtorëve të arsimit në Kosovë. SBASHK vazhdon të jetë shembull i funksionimit të brendshëm demokratik dhe i organizimit profesional sindikal, duke dëshmuar edhe një herë se fuqia e saj qëndron te uniteti, pjesëmarrja dhe përfaqësimi i ndersëm i secilit anëtar.

Për çdo pyetje, sugjerim apo informata shtesë, mund të vizitoni ueb-faqen tonë:

www.sbashk-rks.org


Mos hezitoni të na jepni sugjerime për përfshirjen edhe të ndonjë rubrike në interes të antarësisë në gazetën e juaj elektronike Arsimi SOT.

Që SBASHK-u të jetë gjithnjë në shërbimi të antarësisë, së shpejti do të oftojmë shërbime këshilla për ngritje profesionale për anëtarët e vet si dhe së shpejti do të paraqiten video-spote në uebfaqen e SBASHK-ut rreth shërbimeve për anëtarësinë.

Botues: Sindikata e Bashkuar e Arsimit, Shkencës dhe Kulturës e Kosovës (SBASHK) përfaqëson mbi 24.000 anëtarë në tërë territorin e Kosovës duke përfshirë edhe komunitetet, SBASHK është anëtare e Edukimit Ndërkombëtar që nga viti 1996 me drejta të plota.

Email: info@sbashk-rks.org

Tel: +383 (0) 38 226 940



Intervista

Kryetari Hajdini: Të reduktohet ngarkesa e edukatoreve nëpër kopshte e puna jashtë orarit, të ruhen vendet e punës së mësimdhënësve



Gjatë muajit maj 2025, kur edhe u zgjodh kryetari i ri i SKAP-it në Prishtinë, Qamil Hajdini, SBASHK ka realizuar një intervistë me të për numrin maj të gazetës “Arsimimi sot”, ku edhe ka marrë disa ide dhe synime në drejtim të përmirësimit të kushteve të punës së

mësimdhënësve në kryeqytet.

Kryetari i sapozgjedhur, Qamil Hajdini, tha se si synim kryesor e ka heqjen e ngarkesës së edukatoreve nëpër kopshtet e kryeqytetit, si në rastet kur mungon një edukatore dhe atë detyrohen ta zëvendësojnë edukatoren tjera, ashtu edhe në punën pas orarit.

Hajdini tha se një ndër synimet e tij të cilin do ta adresoj gjatë mandatit sindikal është edhe ruajtja e vendeve të punës për mësimdhënësit, klasat e të cilëve jnaë fuzionuar në mësimtërditor, dhe si rrjedhojë u janë reduktuar orët mësimore.

Hajdini po ashtu premtoi se do të shikoj mundësinë e marrëveshjes me Komunën e Prishtinës për ofrimin e muajoreve të transportit publik për mësimdhënësit-anëtarë të Sindikatës si dhe shumë nevoja tjera në shërbim të anëtarësisë dhe përmirësimit të kushteve të punës së tyre. Për më gjerësisht, ju ftojme ta lexoni intervistën e plotë me kryetarin Qamil Hajdini.

SBASHK: Cila është rëndësia e kryesimit të sindikatës së arsimit në kryeqytet?

Hajdini: Rëndësia e kryesimit të sindikatës në kryeqytet është që ti mbrojmë drejtat e tyre që ju takojnë, të ju japim mundësinë të përfshihen në trajnime, të përqipemi të rrisim numrin e anëtarëve e sidomos rikthimin e anëtarëve të mëhershëm, hulumtimi i mundësive për beneficione për anëtarët e sindikatës, bartjen e kërkesave të sindikalistëve të komunës së Prishtinës në nivelin qendror.

SBASHK: Cilat janë synimet tuaja për zhvillimin edhe më shumë të sindikatës komunale të arsimit?

Hajdini: Rritja e numrit të anëtarëve të sindikatës komunale. Do të përqipem në arritjen e marrëveshjes me kryetarin e Komunës z. Përparim Rama që të pajisen me

një muajore nga ana e sindikatës për anëtarët e sindikatës që të udhëtojnë me Trafikun Urban pa pagesë.

SBASHK: Cilat janë kërkesat e mësimdhënësve në kryeqytet të cilat kërkojnë adresim tek institucionet arsimore të nivelit lokal apo qendror?

Hajdini: Kërkesat për nivelin lokal dhe qendror janë

- Kontrata kolektive,
- Ngarkesa në punë në kopshtet e fëmijëve, edhe kur dikush është në pushim mjekësor apo mungon në duhet të kryejnë punën edhe të tyre dhe nuk paguhen shtesë dmth me pas punëtore që bëjnë zëvendësimet e tyre,
- Puna shtesë në kopshte pas orës 17:00 nuk u paguhet,
- Pushimi vjetor me qenë për të gjithë kopshtin 15.07. deri 15.08, sepse kur disa shkojnë pushime tjerët duhet ta mbulojnë punën e tyre, do të thotë u bie të punojnë dyfish,
- Në shkollimin fillor pagesa të jetë më e lartë për mësimdhënësit mbështetës që punojnë në shkollat ku ka mësim tërditor,
- Gjatë kalimit në mësim tërditor të ruhen vendet e punës së mësimdhënësve të cilët nuk janë fajtor për ndryshimet apo fuzionimet e nxënësve,
- Pajisja e shkollave me tabela të mençura,
- Pagesa e kujdestarisë së klasës,
- Ngritja e pagës të gjithë punëtorëve arsimor në proporcion me ngritjen e çmimeve.

SBASHK: Cilat janë kushtet e punës së mësimdhënësve në Prishtinë, me çka ballafaqohen ata?

Hajdini: Investimet në shkolla mungojnë si psh. disa objekte të vjetra, digjitalizimi i shkollave në hap me kohën, paqartësia rreth mësimi tërditor, rreziku i humbjes së vendeve të punës, në disa shkolla numëri i madh i nxënësve etj.

SBASHK: Dhe për ta përmbyllur këtë intervistë, pyetja jonë për ju është: Cilat janë tri kërkesat më urgjente të punonjësve arsimorë në kryeqytet, që kërkojnë përmirësim?

Hajdini: - Punësimi i punëtorëve rezervë në çerdhe;
- Pajisja e shkollave me tabelat e mençura dhe ofrimi i trajnimeve të nevojshme për përdorimin efikas të tyre nga stafi mësimdhënës;
- Mosfuzioni i nxënësve gjatë kalimit në mësim tërditor.



TRAJNIMET

SBASHK-u, gjatë muajit maj, ka organizuar 17 grupe trajnimi në kuadër të zhvillimit profesional të stafit arsimor

Në vazhden e përkrahjes së anëtarësisë së vet sa i përket ngritjes profesionale dhe përmirësimit të kushteve të punës së tyre, SBASHK-u gjatë muajit maj ka organizuar 17 grupe të trajnimit në dy programe të ndryshme: “Aplikimi i programeve kompjuterike në mësimdhënie” dhe “Forcimi i kapaciteteve për udhëheqje efektive të dialogut social”, nëpër komuna të ndryshme të Kosovës.



Vetëm në vikendin e fundit të muajit, 24-25 maj 2025, SBASHK-u organizoi trajnime në katër komuna të ndryshme të Kosovës. Në Ferizaj filluan dy grupe të trajnimit në programin “Aplikimi i programeve kompjuterike në mësimdhënie” me trajnerët e përcaktuar nga SBASHK-u: Arsim Qalaj dhe Xhemil Halili, derisa një grup i mësimdhënësve e filluan trajnimin në programin “Forcimi i kapaciteteve për udhëheqje efektive të dialogut social”, me trajnerin Emrush Ahmeti i përzgjedhur nga SBASHK-u.



Mësimdhënësit gjatë trajnimit i vizitoi edhe kryetari i SKAP-it për Ferizaj, Fejzullah Vranovci, i cili u interesua nga afër për mbarrëvajtjen e trajnimeve dhe u dëshiroi mësimdhënësve suksese në zhvillimin e tyre profesional.



Në po të njëjtën ditë, me dy grupe të trajnimit filloi edhe Mitrovica ku në programin “Aplikimi i programeve kompjuterike në mësimdhënie”, trajner i përzgjedhur nga SBASHK-u është Kadri Hyseni, kurse në programin “Forcimi i kapaciteteve efektive për udhëheqje të dialogut social”, SBASHK-u e caktoi për trajner, Muhamet Shalën. Kryetari i SKAP-it për Mitrovicë, Isa Ismajli, i vizitoi mësimdhënësit gjatë fillimit të trajnimeve kurse shprehu gatishmërinë e SBASHK-ut për orgnaizimin e trajnimeve dhe ndihmesën e mësimdhënësve në plotësimin e kriterëve për avancim apo licencim.



Sindikata e Bashkuar e Arsimit, Shkencës dhe Kulturës

Po ashtu me dy grupe të trajnimit, të shtunën filloi edhe Peja në programet e njëjta të trajnimit ku një grup i trajnimit filloi në programin “Aplikimi i programeve kompjuterike në mësimdhënie” me trajnerin e përcaktuar nga SBASHK, Burim Krasniqi dhe grupi i dytë në programin “Forcimi i kapaciteteve për udhëheqje efektive të dialogut social”, me trajnerin e përzgjedhur nga SBASHK, Ilir Gashi.



Gjatë vikendit të 24 dhe 25 majit, me një grup të trajnimit filloi edhe Drenasi ku në programin “Aplikimi i programeve kompjuterike në mësimdhënie-moduli 2”, një grup i mësimdhënësve e filluan këtë program të trajnimit, nën udhëheqjen e trajnerit të përcaktuar nga SBASHK, Fejzullah Berisha. Mësimdhënësve po ashtu u dëshiroi suksese në karrierë edhe kryetari i SKAP-it për Drenas, Ilaz Dervishi.

Një javë më parë, në mes të muajit maj, SBASHK kishte filluar edhe me tetë grupe tjera të trajnimeve në tetë komuna të ndryshme të Kosovës.

Edhe në vikendin e 17 e 18 majit, SBASHK filloi me një grup të trajnimit në programin “Aplikimi i programeve kompjuterike në mësimdhënie” në Fushë-Kosovë me trajnerin e përzgjedhur nga SBASHK, Blerona Ahmeti. Mësimdhënësit ishin shprehur falënderues ndaj SBASHK-ut për mundësinë që të ndjekin trajnimet e nevojshme për licencë dhe avancim me mbështetjen e SBASHK-ut. Mësimdhënësit ishin vizituar edhe nga kryetari i SKAP-it për Fushë-Kosovë, Haki Krasniqi.



Një grup i trajnimit në programin e njëjtë gjatë këtij vikendi kishte filluar edhe në Malishevë nën udhëheqjen e trajnerit të përcaktuar nga SBASHK-u, Albert Samadraxha. Edhe mësimdhënësit e Malishevës ishin vizituar nga kryetari i SKAP-it për këtë komunë, Skender Gashi, derisa ishin shprehur mirënjohës për mundësinë e ofruar nga SBASHK.



Grupi i tretë i trajnimit gjatë këtij vikendi kishte nisur në komunën e Klinës, me trajnerin e përzgjedhur nga SBASHK-u, Nexhmedin Gruda. Mbarëvajtjen e trajnimit e kishte përcjellur kryetari i SKAP-it për Klinë, Arif Elezaj, i cili u kishte dëshiruar mësimdhënësve arritje sa më të larta në karrierë.

Edhe Gjilani kishte filluar me një grup të ri të trajnimit me trajnerin e përcaktuar nga SBASHK-u, Ibadete Limani, derisa kryetari i SKAP-it për Gjilan, Blerim Mehmeti, ishte kujdesur për mbarëvajtjen e trajnimit dhe ecurinë e rregullt të tij.

Kurse Obiliqi kishte filluar me një grup të trajnimit në programin “Aplikimi i programeve kompjuterike në mësimdhënie” me trajnerin e përcaktuar nga SBASHK, Xhelal Krasniqi. Për mbarëvajtjen e trajnimit ishte kujdesur edhe kryetarja e SKAP-it për Obiliq, Luljeta Boshnjaku, e cila u kishte dhënë mbështetje prej SBASHK-ut mësimdhënësve në përgatitjet e tyre profesionale.



Sindikata e Bashkuar e Arsimit, Shkencës dhe Kulturës

Komuna e Shtimes po ashtu kishte nisur me një grup të ri të trajnimit, ku trajneri Ferid Shaqiri ishte përcaktuar nga SBASHK për udhëheqjen e mësimdhënësve në trajnimin “Aplikimi i programeve kompjuterike në mësimdhënie”.



Derisa komuna e Vitisë kishte nisur një grup të trajnimit në programin “Aplikimi i programeve kompjuterike në mësimdhënie-moduli 2”, me trajnerin e përcaktuar nga SBASHK-u, Musli Neziri.



Gjatë kësaj jave kishte filluar një grup i vetëm i trajnimit në programin “Forcimi i kapaciteteve për udhëheqje të dialogut social” në Vushtri, me trajnerin e përcaktuar nga SBASHK-u, Zahir Kastrati. Kryetari i SKAP-it për Vushtri, Kadri Hyseni, ishte kujdesur për krijimin e kushteve sa më të përshtatshme për mbarëvajtjen e trajnimit dhe arritje sa më të larta të njohurive nga ana e mësimdhënësve.

Gjithsej gjatë muajit maj SBASHK organizoi 12 grupe të trajnimit në programin “Aplikimi i programeve kompjuterike në mësimdhënie” dhe 5 grupe në programin “Forcimi i kapaciteteve për udhëheqje efektive të dialogut social”.

Gjatë muajit maj SBASHK-u organizoi edhe testet për disa grupe të mësimdhënësve të cilët trajnimin “Aplikimi i programeve kompjuterike në mësimdhënie” e kishin filluar javë më parë dhe e kishin përfunduar të njëjtin me sukses.



Testet për dy grupe të mësimdhënësve u mbajtën të dielën e 25 majit në Podujevë, ku trajnimin “Aplikimi i programeve kompjuterike në mësimdhënie” e përfunduan me sukses dy grupe të mësimdhënësve, nën udhëheqjen e trajnerit, Kadri Hyseni. Testi u administrua nga sekretari i Përgjithshëm në SBASHK, Ymer Ymeri dhe zyrtarja Afërdita Ahmeti.



Paraprakisht, SBASHK mbajti testet për tri grupe të mësimdhënësve në Kaçanik dhe një grup në Drenas.



Të dielën e 18 majit SBASHK-u organizoi testet për tri grupe të mësimdhënësve të cilët e kanë përfunduar me sukses trajnimin në programin “Aplikimi i programeve kompjuterike në mësimdhënie” në Kaçanik ku trajnerët e përzgjedhur nga SBASHK ishin Avni Krasniqi dhe Naser Guri si dhe një grup në Drenas në po të njëjtin program të trajnimit, me trajner Fejzullah Berisha.





Testet në Kaçanik u administruan nga sekretari i Përgjithshëm në SBASHK, Ymer Ymeri dhe zyrtarja Nezafete Jakupi. Kurse testi për një grup të mësimeve në Drenas, u administrua nga nënkryetari e SBASHK-ut, Vjollca Shala dhe zyrtarja Afërdita Ahmeti.



Teste gjatë vikendit paraprak ishin mbajtur edhe në Gjilan e Fushë-Kosovë. Në këtë të fundit testi ishte administruar nga sekretari i Përgjithshëm në SBASHK, Ymer Ymeri dhe zyrtarja, Nezafete Jakupi, kurse në Gjilan nga nënkryetari e SBASHK-ut, Vjollca Shala dhe zyrtari Ligjor, Blendor Shatri.



Gjatë muajit maj, teste ishin mbajtur edhe në Pejë dhe Malishevë për mësime të cilët e kishin ndjekur me sukses trajnimin “Aplikimi i programeve kompjuterike në mësime”. Testit në Pejë u ishte nënshtruar një grup i mësimeve i cili ishte udhëhequr nga trajneri Burim Krasniqi, kurse testi ishte administruar nga sekretari i Përgjithshëm në SBASHK, Ymer Ymeri dhe zyrtarja Nezafete Jakupi.



Ndërsa në Malishevë testi ishte administruar nga nënkryetari e SBASHK-ut, Vjollca Shala dhe zyrtari Ligjor, Blendor Shatri. Grupi i trajnimit në programin “Aplikimi i programeve kompjuterike në mësime” në Malishevë ishte udhëhequr nga trajneri, Albert Samadraxha.



Ndërsa dy grupe të testimit ishin mbajtur në Prishtinë, për mësime të cilët e kishin filluar javë më parë këtë trajnim e që e kishin përfunduar me sukses, nën udhëheqjen e trajnerit, Nexhmedin Gruda. Testi ishte administruar nga sekretari i Përgjithshëm në SBASHK, Ymer Ymeri, zyrtari Ligjor, Blendor Shatri dhe zyrtarja Nezafete Jakupi.



Organizimi i trajnimeve nga SBASHK-u në shërbim të anëtarësisë po vazhdon me kërkesë të shumë mësimeve të cilat po u shërbejnë për zhvillim profesional dhe të karrierës.

SBASHK po vazhdon me zgjedhjet sindikale, gjatë majit zgjedhjet përfunduan në disa komuna



Gjatë muajit maj, SBASHK ka përfunduar zgjedhjet sindikale në disa komuna të Kosovës, derisa ato po vazhdojnë në të gjitha komunat tjera me proces të rregullt dhe demokratik. Zgjedhjet Sindikale u organizuan në Klinë, ku kryetar u rizgjodh Arif Elezaj, kurse nënkryetar Islam Kalludra.



Të enjten e 29 majit, në Klinë u mbajt Kuvendi Zgjedhor i Sindikatës Komunale të Arsimit Parauniversitar (SKAP), ku u zgjodhën kryetari, nënkryetari, kryesia e re e SKAP-it të Klinës, delegatët për Kongresin e SBASHK-ut, si dhe anëtarët për Këshillin Drejtues të SBASHK-ut.



Ky kuvend u organizua në kuadër të zgjedhjeve të rregullta ku në vitin 2025 po mbahen zgjedhjet për të gjitha shoqatat sindikale dhe për nivelet komunale, universitare dhe të kulturës që veprojnë në kuadër të SBASHK-ut. Këshilli Drejtues kishte shpallur këtë vit si vit zgjedhor që në fillim të vitit kalendarik. Procesi zgjedhor në Klinë u zhvillua në mënyrë të rregullt, demokratike dhe pa asnjë pengesë.



Kryetar i SKAP-it për Klinë u rizgjodh Arif Elezaj kurse nënkryetar, Islam Kalludra.



Më 27 maj zgjedhjet Sindikale u mbajtën edhe në Shtërpçë ku u zgjodh kryetari, nënkryetarja dhe organet drejtuese të SKAP-it.



Ky kuvend u organizua në kuadër të zgjedhjeve të rregullta ku në vitin 2025 po mbahen zgjedhjet për të gjitha shoqatat sindikale dhe për nivelet komunale, universitare dhe të kulturës që veprojnë në kuadër të SBASHK-ut. Këshilli Drejtues kishte shpallur këtë vit si vit zgjedhor që në fillim të vitit kalendarik. Procesi zgjedhor në Shtërpçë u zhvillua në mënyrë të rregullt, demokratike dhe pa asnjë pengesë. Nga votimi i fshehtë, ku morën pjesë edhe kundërkandidatët, kryetar i SKAP-it për Shtërpçë u zgjodh Avni Shabani, ndërsa nënkryetare u zgjodh Besa Hyseni.



Gjatë këtij muaji, zgjedhjet sindikale përfunduan edhe në Kamenicë, ku u rizgjodhen: Kryetar Lulzim Thaqi, Nënkyetare Mense Morina dhe organet drejtuese të SKAP-it.



Gjatë Kuvendit Zgjedhor të Sindikatës Komunale të Arsimit Parauniversitar (SKAP), në Kamenicë u zgjodh edhe kryesia e re delegatët për Kongresin e SBASHK-ut, si dhe anëtarët për Këshillin Drejtues të SBASHK-ut. Procesi zgjedhor në Kamenicë me votim të fshehtë, u zhvillua në mënyrë të rregullt, demokratike dhe pa asnjë pengesë.



Zgjedhjet sindikale u mbajtën edhe në Prishtinë, ku në mbledhjen e rregullt të Kuvendit Zgjedhor të Sindikatës Komunale të Arsimit Parauniversitar në Prishtinë, u zgjodhën drejtuesit e rinj të kësaj sindikate për mandatin e ardhshëm katërvjeçar. Me shumicë votash, u zgjodh kryetar Qamil Hajdini dhe nënkryetare, Florije Kadriu.



Në këtë kuvend morën pjesë edhe përfaqësues të lartë të SBASHK-ut, Vjollca Shala – nënkryetare, Ymer Ymeri – sekretar i Përgjithshëm, dhe Blendor Shatri – zyrtar ligjor, të cilët përshëndetën punimet e kuvendit, uruan punë të mbarë dhe shprehën mbështetje të plotë për drejtuesit e rinj në misionin e tyre për përfaqësimin dhe mbrojtjen e të drejtave të punëtorëve të arsimit në Komunën e Prishtinës. Në përputhje me rendin e ditës, fillimisht u zgjodh Komisioni për verifikimin e mandateve dhe numërimin e votave, ndërsa më pas, përmes votimit të fshehtë, u zgjodhën kryetari dhe nënkryetari.



Anëtarët e Kryesisë dhe Komisioni Mbikëqyrës i Sindikatës Komunale do të zgjidhen në mbledhjen e ardhshme të Kuvendit. Urime të përzemërta të zgjedhurve dhe suksese në përfaqësimin e denjë të punëtorëve të arsimit në kryeqytet!

SBASHK-u merr pjesë në Forumin e Këshillit Ekonomik Social Evropian për Ballkanin Perëndimor



Në Beçiq të Malit të Zi, gjatë muajit maj kishte mbajtur punimet Forumi i 10-të i Shoqërisë Civile të Ballkanit Perëndimor, i organizuar nga Këshilli Ekonomik Social Evropian (KESE), në të cilin kishin marrë pjesë edhe dy përfaqësues të SBASHK-ut: Vjollca Shala, nënkryetare e SBASHK-ut, dhe Ymer Ymeri, sekretar i Përgjithshëm.



Ky forum kishte mbledhë përfaqësues të organizatave të shoqërisë civile dhe partnerëve socialë nga i gjithë Ballkani Perëndimor, për të diskutuar dhe dhënë kontribut konkret në agjendën evropiane të rajonit përgjatë dy ditëve të 13 dhe 14 majit 2025.



Forum i ishte fokusuar në temat kyçe si: Përshpejtimi i anëtarësimit në BE për Ballkanin Perëndimor, Roli i shoqërisë civile të organizuar në negociatat e anëtarësimit dhe Plani dhe Instrumenti i Rritjes për Ballkanin Perëndimor – fokusi në bazat, Kontributi i partnerëve socialë dhe organizatave të shoqërisë civile në zbatimin e Planit dhe Instrumentit të Rritjes për Ballkanin Perëndimor – Tregu i Vetëm, Tregtia dhe Marrëveshja e Pastër Industrial dhe Tregu i Përbashkët Rajonal (CRM), nxitja e mjedisit të biznesit, drejtësisë sociale dhe transformimit digjital, Kontributi i partnerëve social dhe organizatave të shoqërisë civile në zbatimin e Shtyllës Evropiane të Drejtave Sociale në Ballkanin Perëndimor - më shumë dhe më mirë vende pune dhe zhvillimi i aftësive dhe mbrojtja sociale, barazia dhe përfshirja.



SBASHK-u, përveç angazhimit të vazhdueshëm për mbrojtjen e të drejtave dhe interesave të punëtorëve të arsimit në Kosovë, po jep kontributin e vet edhe në avancimin e agjendës evropiane nëpërmjet pjesëmarrjes aktive në platformat rajonale dhe evropiane siç është KESE.



Përmes këtij angazhimi, SBASHK-u synon të japë zërin e punëtorëve të arsimit në procesin e integrimit evropian dhe të kontribuojë që edhe Kosova të jetë pjesë e Bashkimit Evropian, me një shoqëri më të drejtë, më të barabartë dhe më të zhvilluar për të gjithë.



Në kuadër të Akademisë për Drejtësi Sociale, u mbajt një prezantim i veçantë me temën: “Liria e bashkimit dhe organizimit në sindikatë – Rasti i SBASHK-ut”, i cili trajtoi në thellësi rëndësinë e të drejtës për organizim sindikal në një shoqëri demokratike. Prezantimi, i mbajtur nga z. Ymer Ymeri, u vlerësua lart nga pjesëmarrësit si një paraqitje e qartë, e argumentuar dhe e frymëzuar nga përvoja konkrete shumëvjeçare e SBASHK-ut. Z. Ymeri u cilësua si një përfaqësues dinjitoz dhe bindës, që përçoi me pasion dhe profesionalizëm rolin thelbësor që sindikata ka luajtur në mbrojtjen e të drejtave të punëtorëve në arsim. Në fokus të prezantimit ishin katër fazat historike të veprimit të SBASHK-ut: Vitet ‘90: Organizimi i sistemit paralel të arsimit shqip dhe rezistenca paqësore ndaj diskriminimit institucional. Gjatë luftës (1998–1999): Angazhimi i

mësimdhënësve në mësimdhënie edhe në kushte të rënda, përfshirë shkollat në kampet e refugjatëve. Pas luftës: Kontributi në rindërtimin e sistemit arsimor, negocimi për kontrata kolektive dhe përmirësim të kushteve të punës. Aktiviteti i vazhdueshëm sindikal: Grevat, protestat dhe përfaqësimi i fuqishëm institucional për të drejtat e arsimtarëve. Gjatë diskutimit, SBASHK-u u vlerësua si një nga sindikatat më aktive, të organizuara dhe me ndikim të qëndrueshëm në shoqërinë kosovare. Prezantimi solli jo vetëm fakte, por edhe emocione, duke kujtuar rolin historik që kjo sindikatë ka pasur në ruajtjen e arsimit dhe dinjitetit profesional të mësimdhënësve ndër dekada. Ky takim shërbeu si një reflektim mbi vlerën e organizimit kolektiv, fuqinë e zërit të punëtorëve dhe nevojën për drejtësi sociale reale në çdo nivel të jetës publike.

